



## SHËNIME SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2018

### 1. Të përgjithshme

Pasqyrat financiare të Ujësllës Kanalizime Korçë janë hartuar në zbatim të Ligjit Nr 9228 dt 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"

Pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike::

- (a) ato janë të sakta e të plota në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike;
- (b) përgatitja e tyre bazohet në vlerësime të arsyeshme e të bazuara( në rastet kur vlerësimet janë të domosdoshme); dhe
- (c) shënimet në pasqyrat financiare janë përgatitur me detaje të mjaftueshme për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të një njësie ekonomike, në mënyrë të tillë që lexuesit kompetentë të mund të nxjerrin konkluzione të arsyeshme.

Ujësllës Kanalizime Korçë është një Shoqëri Aksionare e rregjistruar me datë themelimi 17/03/2000, me aktivitet kryesor

- a) Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm I konsumatorëve dhe shitja e tij;
- b) Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
- ç) Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
- d) Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse te Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per tregetaret dhe shoqerite tregtare", Statutit të Shoqërisë, VKM Nr. 63, datë 27.1.2016 Për Riorganizimin E Operatorëve Që Ofrojnë Shërbimin E Furnizimit Me Ujë Të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin Dhe Trajtimin E Ujërave Të Ndotura"

#### **Organet e drejtimit të shoqërisë janë:**

- a) Asambleja e Përgjithshme;
- b) Këshilli i Administrimi

Bashkia Korçë zotëron 100% të aksioneve të Shoqërisë.

Numri mesatar i punonjesve për vitin 2018 është 115 punonjë.

Nr	EMERTIMI I AKTIVEVE AFATGJATA	Fondet investimit e	Norma e amortizimit 2018	Fondet investimit e	Norma e amortizimit 2018
		UJESJELLES		KANALIZIME	
1	Ndërtesat			5%	
2	Ndërtime dhe instalime te pergjithshme/ Impianti Fotovoltaik			5%	
3	Instalime specifike dhe komplekse	Me fondet e UKKO	1.5%	Para vitit 2000	5%
		Kredi		Me fondet e UKKO	1%
		Dhurate		Kredi	1%
	Instalime specifike dhe komplekse Njesia Administrative	Me fondet e UKKO	1.5%	Me fondet e UKKO	1%
		Ujesjellesi i vjeter	5%	Kanalizimet e vjetra	5%
4	Matesat elektronik	Kredi	10%		
		Me fondet e UKKO			
5	Makineri dhe paisje pune			20%	
6	Mjete transporti			20%	
7	Mobilje orendi			20%	
8	Mjete kompjuterike			25%	
9	Aktive Afatgjata jo materiale			15%	

Per llogaritjen e amortizimit te AAJM (SKK 5: ) njesia ekonomike raportuese ka percaktuar si metode te amortizimit ate lineare me normen e amortizimit 15 % ne vit.

22	Union Bank	ALL	41 01 12 71 00 30 112			17,028,264
23	Alpha Bank	ALL	902 012 123 000 300 587			1,658,250
24	ABI Bank	ALL	207 113 10 000 02 7			357,700
29	Tirana Bank	ALL	5.00383E+11			1,635,018
30	Sosiete Generale Albania	ALL	1265632			1,555,540
<b>Totali</b>						<b>324,912,228</b>

### Të drejta të arkëtueshme 221,424,748 lekë.

Përfshijne kërkesa të arkëtueshme afatshkurtra (klientë), ku përfshihen të gjithë debitorët faturat e të cilëve nuk janë arkëtuar.

Vlera e Të drejtave të arkëtueshme është 233,185,894 lekë dhe përfshin klientët debitorë që nga viti 2011 deri në 31.12.2018.

Në mbeshtetje të Ligjit Nr. 8438, Datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi Të Ardhurat! Ndryshuar", si edhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 6 Provizionet, Detyrimet Dhe Aktivitet E Kushtëzuara,

Shoqëria krijoi dhe Miratimoi nga Këshilli i Administrimit vlerën prej 13.072.451 lekë për klasën "Të drejta të arkëtueshme"- Nga aktiviteti i shfrytëzimit i emërtuar në llogaritë e kontabilitetit si Llogaria 411.

Provizionit është bërë konform Standardeteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara, SKK 6 Provizionet, Detyrimet Dhe Aktivitet E Kushtëzuara dhe më konkretisht,

Provizioni është një detyrim aktual, për të cilin koha e shlyerjes ose shuma janë të pasigurta. Fusha e zbatimit të Provizionit janë të gjitha detyrimet dhe të ardhurat SKK 8 . që kanë kohën e shlyerjes dhe shumën të pasigurta).

Gjithashtu për klientët të cilët nuk kanë paguar faturat dhe janë çuar në proces gjyqësor për të shlyer detyrimet në total me vlerë 11,761,146 lekë janë zbritur nga llogari Të drejta të arkëtueshme.

#### A - NJOHJA E PROVIZIONEVE

*Njësia ekonomike do ta njohë provizionin si një detyrim në pasqyrën e pozicionit financiar dhe shumën e tij si një shpenzim, përveç rastit kur një SKK tjetër kërkon që kostoja të njihet si pjesë e koston së një aktivi si p.sh. inventar ose tokë, ndërtesa, makineri dhe pajisje.*

*Njësia ekonomike do ta njohë një provizion vetëm kur e ashtuquajtura ngjarje detyruese ka ndodhur para datës së raportimit.*



*Krijimi i një provizioni të ri, ose rritja e një provizioni ekzistues, zakonisht regjistrohet si një shpenzim i periudhës kontabël.*

*Përsa sqaruar më sipër kushtet mbi të cilat një e drejtë e arkëtueshme me probabilitet për të mos u arkëtuar mund të kalojë në provizion, UKKO për të pasqyruar një situatë të qartë sipas SKK1, ka kryer një analizë të detajuar të të drejtave të arkëtueshme duke filluar që nga viti 2008, kur u falën të gjitha detyrimet dhe kamatvonesat.*

#### **Të tjera të arkëtueshme**

- a) Shteti debitor për tatim fitimin për vitin 2018 me vlerë 539,942 lekë
- b) Shteti- TVSH për tu marrë 2,305,839 Lekë

**Të drejta të arkëtueshme nga proceset gjyqesore 33,697,855.70 lekë.**

Këtu përfshihen të drejtat për arkëtim nga prices gjyqësore në të vilat UKKO është përfshirë.

#### **Inventaret 84,530,975 Lekë**

Inventarët e njësive prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proçes dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare si dhe Aktive Biologjike (Gjë e gjallë në rritje e majmëri) te vleresuara sipas Modeli i Kostos ose Modeli i Vlerës së Drejtë.

Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Materiale 84,530,975 Lekë

(Inventarët analitike bashkangjitur)

**AKTIVE TOTALE AFATSHKURTRA 669,054,538 LEKË.**

#### **Aktivët afatgjata**

Aktive financiare përfshijnetituj pronësie në njësitë ekonomike brenda grupit, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike brenda grupi, tituj pronësie në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, tituj të huadhënies në njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, Tituj të tjerë të mbajtur si aktive afatgjata letrat me vlerë (aksionet, bono të thesarit, obligacione, zotërime në fonde investimesh, etj) që nuk ka gjasa të shiten brenda 12

muajve të ardhshëm te paraqitura me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm

**Tituj të tjerë të huadhenies (të drejta të arkëtueshme) 148,320,667 lekë është**

Në Bazë të Marrëveshjes ndërmjet Ujësjiellës Kanalizime Korçë dhe Bashkisë Korçë është nënshkruar një Marrëveshje "Mbështetjen financiare për Sh.A Ujësjiellës Kanalizime Korçë nga Bashkia Korçë" në datën 04.02.2010 me Nr Prot 45 ku Palët Bashkia Korçë merr angazhim të mbështesë UKKO për një periudhë 16 vjeçare në total 1.390.000 Euro.

### Aktivët Afatgjatë Materiale

Ne bilanc AAM përfshijnë Toka dhe ndërtesa, impiante dhe makineri, të tjera Instalime dhe pajisje që paraqiten me kosto e amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm si dhe parapagime për aktive materiale dhe në proces që paraqiten me vlera nominale e shumës së parapaguar.

### Toka dhe ndërtesa

Vlera fillestare 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Toka	13,214,592			13,214,592
2	Ndertesë	952,259,555			952,259,555
	<b>TOTALI</b>	<b>965,474,147</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>965,474,147</b>
Amortizimi 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Toka	-			-
2	Ndertesë	211,064,906	37,059,733		248,124,639
	<b>TOTALI</b>	<b>211,064,906</b>	<b>37,059,733</b>	<b>-</b>	<b>248,124,639</b>
Vlera Kontabel Neto 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Toka	13,214,592	0	0	13,214,592
2	Ndertesë	741,194,649	0	37,059,733	704,134,916
	<b>TOTALI</b>	<b>754,409,241</b>	<b>0</b>	<b>37,059,733</b>	<b>717,349,508</b>

**Instalime dhe Impiante**

Analiza e posteve te amortizushme

Vlera fillestare 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	1,111,411,637			1,111,411,637
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	5,989,192,736	518,062,896	50968440	6,456,287,192
	<b>TOTALI</b>	<b>7,100,604,373</b>	<b>518,062,896</b>	<b>50,968,440</b>	<b>7,567,698,829</b>
Amortizimi 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	252,127,360	42,964,214	12,103,875	282,987,699
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	1,089,020,068	67,000,721	20,006,756	1,136,014,033
	<b>TOTALI</b>	<b>1,341,147,428</b>	<b>109,964,935</b>	<b>32,110,631</b>	<b>1,419,001,732</b>
Vlera Kontabel Neto 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Ndërtime dhe instalime të përgjithshme + IMPIANTE	859,284,277	0	30,860,339	828,423,938
2	Instalime teknike specifike dhe komplekse	4,900,172,668	467,094,456	46,993,966	5,320,273,158
	<b>TOTALI</b>	<b>5,759,456,945</b>	<b>467,094,456</b>	<b>77,854,305</b>	<b>6,148,697,097</b>



**Të tjera Instalime dhe pajisje**

Analiza e posteve te amortizushme

Vlera fillestare 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Makineri e paisje	107,415,858	99,683	10,204,478	97,311,063
2	Mjete Transporti	80,609,625	15,806,950		96,416,575
3	Mobilje, orendi	18,811,940	199,000	119,985	18,890,955
4	Paisje Zyre, informatike	134,693,740	787,550	4,483,130	130,998,160
5	Matesa elektronik	371,014,700	1,452,689		372,467,389
	<b>TOTALI</b>	<b>712,545,863</b>	<b>18,345,872</b>	<b>14,807,593</b>	<b>716,084,142</b>
Amortizimi 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Makineri e paisje	69,282,264	7,637,590	9,443,263	67,476,591
2	Mjete Transporti	63,900,083	4,557,821		68,457,904
3	Mobilje, orendi	13,462,146	1,080,276	98,428	14,443,994
4	Paisje Zyre, informatike	81,716,902	13,253,350	3,539,733	91,430,520
5	Matesa elektronik	13,188,910	35,851,207		49,040,117
	<b>TOTALI</b>	<b>241,550,306</b>	<b>62,380,245</b>	<b>13,081,424</b>	<b>290,849,127</b>
Vlera Kontabel Neto 2018					
Nr	Emertimi	Gjendje	Shtesa	Pakesime	Gjendje
		1/1/2018			12/31/2018
1	Makineri e paisje	38,133,594	99,683	8,398,805	29,834,471
2	Mjete Transporti	16,709,542	15,806,950	4,557,821	27,958,671
3	Mobilje, orendi	5,349,794	199,000	1,101,833	4,446,961
4	Paisje Zyre, informatike	52,976,838	787,550	14,196,747	39,567,640
5	Matesa elektronik	357,825,790	1,452,689	35,851,206	323,427,273
	<b>TOTALI</b>	<b>470,995,557</b>	<b>18,345,872</b>	<b>64,106,413</b>	<b>425,235,015</b>

**Aktivet afatgjata jomateriale (AAJM) me vlerë 56,081,330 lekë.**

janë aktive të identifikueshme jomonetare pa përmbajtje fizike, të mbajtura për qëllim prodhimin e produkteve ose furnizimin e mallrave ose shërbimeve, për t'ua dhënë me qira të tretëve ose për qëllime administrative ato paraqiten me Kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi me vlerë 56,081,330 lekë.

Në total Shoqëria ka në shtesë të aktiveve Afatgjata Materiale prej 580,329,328 lekë dhe zvogëlim prej 421,474,972 lekë si rezultat i inventarizimeve dhe vlerësiemve të aseteve dhe nxjerrjes jashtë përdorimit.

**UKKO në total ka një total të aseteve prej 8,166,847,415 lekë.**

## **PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR (BILANCI)- PASIVET**

### **Detyrime Afatshkurtra 29,603,790 lekë**

*Detyrimet afatshkurtra Një njësi ekonomike duhet ta klasifikojë një detyrim si afatshkurtër kur: (a) ajo pret ta shlyejë detyrimin brenda ciklit normal të shfrytëzimit të njësisë ekonomike; (b) ajo e mban detyrimin kryesisht për qëllime tregtimi; (c) detyrimi do të shlyhet brenda dymbëdhjetë muajve pas datës së raportimit; ose (d) njësi ekonomike nuk ka një të drejtë të pakushtëzuar për të evituar shlyerjen e detyrimit për të paktën dymbëdhjetë muaj pas datës së raportimit.*

### **Arkëtime në avancë për porosi 242,517 lekë**

Përbëjnë fatura të paguara dy herë nga klientët dhe që UKKO do ti sistemojë në vijëmesi.

### **Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 18,200,291 lekë.**

Këtu përfshihen detyrime afatshkurtra që UKKO ka për palët e treta, Furnitorë për shërbime 4,946,330, Furnitorë për mallra 9,915,602 , Energji elektrike dhe ujë 3,338,358 lekë.

### **Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore 2,742,740 lekë.**

Përbëjnë detyrimet afatshkurtra që UKKO ka ndaj stafit që është pjesë e projektit Waternergy Cycle të financuar nga Bashkimi Europian sipas thirrjes BalkanMed. Sipas kushteve të projektit këto detyrime do të shlyhen nga UKKO dhe më pas do të rimbursohen në vlerën 85%.

### **Të pagueshme për detyrimet tatimore 2,531,094 lekë**

Përbëjnë detyrimet afatshkurtra të cilat përbëjnë detyrimet e muajit Dhjetor 2018 të cilat paguhen në Janar 2019 – Sigurime shoqërore Shëndetësore 1,987,529 lekë, Tatimi mbi të ardhurat 536,935 lekë, Tatim në burim 6630 lekë.

### **Të pagueshme për detyrimet tatimore 2,295,393 lekë**

Përbëjnë Tatim fitimin që I përket vitit 2015, 2016, 2017 si rezultat I sistemimit të Shpenzimeve të Amortizimit Për Klasën Instalime teknike Komplekse Impianti Fotovoltaik I llogaritu gabimisht dy here me vlerë për t'u sistemuar 12.103.875 lekë.

Korrigjimi i gabimeve është bere sipas SKK 1 i permiresuar, pika112.a

*Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korrigjohen, sipas njëres prej dy mënyrave të mëposhtme: (a) në retrospektivë, që do të thotë se shumat e korrigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke*



*rregulluar tepriçën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundshme;*

Njesia ekonomike ka llogaritur efektin e Tatim fitimit dhe gjobat për pagesë të vonuar sipas Ligji 9920, dt. 19.05.2008 PËR PROCEDURAT TATIMORE NË R.SH.

Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit “ *Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.* ”

Neni 115 Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore

*“ Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. 2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar.”*

Shuma e Tatim Fitimit + gjobat + interesat që rezultuan nga sistemimi i mësipërm janë paraqitur në Pasiv dhe Kapital.

#### **Të tjera të pagueshme 3,591,756 lekë**

Përfshihen taksat e Bashkisë që qytetarët paguajnë në fatyrën e ujit. Këto vlera arkëtohen nga UKKO nëpërmjet arketimit të faturave dhe më pas depozitohen në degën e Të Ardhuave të Bashkisë.

#### **Të ardhura të shtyra 92,568,812 lekë**

Përbëhen nga Shepnzime të interesave të papaguara të kredive 91,487,133 lekë. Sistemimi i granteve/ sistemim dalja e materialeve nga magazina 1,081,679 lekë.

#### **Detyrime ndaj institucioneve të kredisë 4,991,938,317 lekë**

Përfshihen të gjitha detyrimet ndaj institucioneve Financiare për kreditë e marra nga UKKO. Që prej vitit 2010 UKKO ka nisur të shlyejë kreditë sipas Amortizimeve përkatëse.

#### **Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit 147,262,504 lekë.**

Përfshihen detyrimet nga Furnitorëve ITS SHPK dhe FMO SHPK sipas Kontratave të Financimit dhe intaslimit të Matësave elektrike dhe Impiantit fotovoltaiik për prodhimin e energjise elektrike.

**Të ardhura të shtyra afatgjata 2,479,704,450 lekë**

Përshihen Grante afatgjata me vlerë 2,341,013,297 lekë, që i takojnë granteve që UKKO ka përfituar gjatë investimeve të kryera në rrjetin Ujësjetellës dhe Kanalizime. Vlera është në vlerë neto duhe zbritur amortizimet vjetore të asete.

**Detyrimi i mbetur i Bashkisë Korçë sipas kontratës 138,691,153 lekë**

UKKO dhe Bashkia Korçë në kudër të Projektit të Kanalizimeve “ Kanalizime Korça IV” në bazë dhe për zbatim të Marrëveshjes së Financimit midis Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit, Sh.A Ujësjetellës Kanalizime Korçë dhe KFW , Pika 4 Faqe 7 sipas së Cilës Bashkia Korçë do të kontribuojë duke mbështetur financiarisht Ujësjetellës Kanalizime Korçë me me një kontribut total prej 1,390,000 Euro.

## KAPITALI

**Kapitali i Nënshkruar 370,708,000 Lekë**

Kapitali i Nënshkruarparaqitet me Vlerën kontabël e kapitalit aksionar të emetuar

**Rezerva rivlerësimi 6,407,302 lekë****Rezerva ligjore 3,779,454 lekë****Rezerva statutore 27,122,404 lekë****Fitimet e pashpërndara 9,808,482 Lekë.**

Fitimi i pashpërndarë paraqet Fitimi/humbjen e akumuluar nga periudhat kontabël të mëparshme që as nuk është paguar si dividend dhe as nuk është përdorur për ndonjë qëllim tjetër nga njësia ekonomike (për shembull për zmadhimin e kapitalit aksionar ose rezervave). Shuma 9, 808,482 Lekë përfaqeson vlerën neto të fitimit për korigjimin e gabimeve të vitit 2015, mbas zbritjes së detyrimit për tatim fitim, gjoba dhe interesa të llogaritura për pagesë të vonuar. Gjate vitit 2015 Fitimi ka qënë 7,888,782 lekë dhe është paguar tatim fitim 1,269,995 lekë.

Njësia ekonomike ka llogaritur efektin e Tatim fitimit dhe gjobat për pagesë të vonuar sipas:

**SKK 1 i permiresuar , pika112.a**

*Gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme do të korigjohen, sipas njërës prej dy mënyrave të mëposhtme: (a) në retrospektivë, që do të thotë se shuma e korigjimit të një gabimi material, që lidhet me periudhat kontabël të mëparshme, do të raportohet duke rregulluar tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Informacioni krahasues duhet të riparaqitet, nëse është praktikisht e mundshme;*

*Ligji 9920, dt. 19.05.2008 PËR PROCEDURAT TATIMORE NË R.SH.*



*Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit " Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. "*

*Neni 115 Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*

*" Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. 2. Për qëllime të këtij neni, shuma e papaguar e detyrimit tatimor është diferenca ndërmjet detyrimit tatimor, që duhet paguar dhe shumës së tatimit të paguar."*

**Fitimi neto i vitit ushtrimor 2018 është 7,943,900 lekë**

## PASQYRA E PERFORMANCES

### TË ARDHURAT

#### Njohja e të ardhurave

*Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto, të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitalit.*

*Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri.*

*Një njësi ekonomike duhet të masë të ardhurat me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme. Vlera e drejtë e shumës së arkëtuar apo për t'u arkëtuar merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.*

*Kur rezultati i një transaksioni që përfshin ofrimin e një shërbimi mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat e lidhura me transaksionin duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit në fund të periudhës raportuese (nganjëherë referuar si metoda e përqindjes së përfundimit).*

**Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit 373,868,013 lekë**

Përfshihen të ardhurat nga Faturimi i ujit të pijshëm, Ujit të nodotur, Tarifës së Shërbimit si edhe pikat e reja të lidhjeve.

**Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar 7,775,990 lekë**

Janë shuma e mterialeve të dala nga magazina të përdorura në investime duke shtuar Asetet.

**Të ardhura të tjera të shfrytëzimit 88,608,479 lekë**

Përbëhen nga të ardhurat nga investimet e Granteve dhe të ardhura të tjera.

**Të ardhurat financiare**

Të ardhurat financiare përmbledhin të ardhurat nga interesi nga fondet e depozituara ne banka, fitimet nga shitja aktiveve financiare te mbajtura per shitje, si dhe fitimet nga kembimet valutore. Te ardhurat nga interesi njihen si detyrime atehere kur perdoret metoda e interesit efektiv

**Të ardhura nga njësitë ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit) Te ardhura nga Grantet 35,028,000 lekë.**

**Interesa të arkëtueshme dhe të ardhura të tjera të ngjashme (paraqitur veçmas të ardhurat nga njësitë ekonomike brenda grupit) 17,611,972 lekë**

Përfshihen të ardhurat nga intereasat dhe kamatvonesat

**Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit 9,908,008 lekë**

Transaksionet ne monedha te huaja konvertohen ne monedhen e perdorur duke perdorur kurset e kembimit ne daten e kryerjes se transaksionit. Fitimi nga ndryshimi i kursit të këmbimit në dt 31.12.2018

**SHPENZIMET**

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpërndarjet te pjesëmarrësit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri. Shpenzimet per kerkime e zhvillime pergjithesisht jane ngarjuar ne llogarine e shpenzimeve ne periudhen se ciles i perkasin.

**Lënda e parë 20,409,216 lekë**

Përbën shumën e materialeve të dala nga magazina gjatë periudhës për kryerjen e Shpenzimeve dhe Mirëmbajtjes.

**Materiale të konsumueshme 31,061,994 lekë**

Vlera e shpenzimeve të energjisë elektrike dhe ujit.

**Shpenzime të personelit 99,716,724 lekë**

Paga dhe shpërblime	78,994,899 lekë
Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore	13,670,018 lekë
Shpenzime të tjera personeli	7,051,807 lekë
<b>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</b>	<b>283,127,967 lekë</b>
<b>Shpenzime të tjera shfrytëzimi</b>	<b>42,011,526 lekë</b>
Shërbime nga të tretë	21,739,041 lekë
Tatime, Taksa, tarifa kontraktuale, Sigurime, etj	3,639,112 lekë
Shpenzime të tjera	16,633,373 lekë
<b>Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme</b>	<b>44,672,786 lekë</b>
Fitimi/humbja para tatimit	11,800,249 lekë
Tatimi fitimi	3,856,349 lekë
Fitimi neto	7,943,900 lekë

#### PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE (Metoda direkte)

Pasqyrat fluksi monetar është hartuar sipas SKK 2 .

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës kontabël. 62. Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare jep informacion në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veças ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit. Krahasuar me vitin paraardhës kemi një rritje të mjeteve monetare me 42,357,077 lekë.

Pasqyra e fluksit monetar është hartuar sipas Metodës direkte.

#### PASQYRA E NDYSHIMEVE TË KAPITALIT - PERIUDHA 1 JANAR - 31 DHJETOR 2018

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto është hartuar sipas SKK 2 dhe paraqet fitimin e një njësie ekonomike ose humbjen për një periudhë të raportimit, zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura në pasqyrën e performancës për periudhën, efektet e ndryshimeve në politikat kontabël dhe korigjimet e gabimeve të njohura në periudhën dhe shumatat e investimeve, dividendët dhe shpërndarjet e tjera ndaj investitorëve të kapitalit neto gjatë periudhës.



**C - Shënime të tjera shpjeguese**

Ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat behen rregullime apo ngjarje te ndodhura pas dates se bilancit per te cilat nuk behen rregullime Nuk ka.

Gabime materiale te ndodhura ne periudhat kontabel te mepareshme te konstatuara gjate periudhes rraportuese dhe qe korigjim. Nuk ka.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Elia Pendavinji

(Drejtoreshi i Drejtorisë Tregëtare)

Për Drejtimin e Njesisë Ekonomike

Petrit Tare

(Drejtor i Përgjithshëm)